

LIBRI IV

Çfarë duhet të prisni
**KËRKESA IME
PËR AZIL**



MIRË SE VINI!



Ky tregim flet për katër të rinj — si ju.

Ata kanë mbërritur shëndoshë e mirë në Evropë pas një udhëtimi të gjatë.
Disa prej tyre kanë ardhur vetëm. Disa të tjerë kanë ardhur me familjen.
Ata kanë shumë pyetje, ndaj u duhet ndihma e njerëzve që punojnë aty ku ata jetojnë.



Ky tregim mund t'ju ndihmojë edhe ju!

Do të mësoni:

- çfarë do të thotë procedura e azilit
- çfarë duhet të prisni
- pse është e nevojshme që të përfshihenit dhe të bashkëpunoni me nëpunësit
- kush mund t'ju ndihmojë
- në lidhje me të drejtat tuaja

Ju mund ta lexoni këtë tregim:

- vetëm
- me një mik
- me dikë që punon këtu



Merrni kohën tuaj. Është në rregull nëse bëni një pushim dhe i ktheheni më vonë.

Nëse keni vështirësi për të kuptuar diçka, kërkojini dikujt t'ju shpjegojë.
Mund t'ju ndihmojë kujdestari, punonjësi social ose avokati juaj.

NË FUND, DO TË GJENI:

-  një faqe me informacione rreth vendit
-  një kuiz zbatimës
-  hapësirë për të shkruar pyetjet tuaja dhe për të shtuar kontakte të dobishme

Për personat nën 18 vjeç që mbërrijnë të vetëm, do të caktohet një kujdestar. Në disa vende, kujdestari quhet edhe përfaqësues. Gjithashtu, në disa vende, kërkesa për azil quhet kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.



Së fundi, kini parasysh se të gjitha shërbimet e ofruara në qendrat e pritjes ku po qëndroni janë pa pagesë. Nëse një pjesëtar i stafit ju kërkon para, bisedoni me një nëpunës të besuar ose me kujdestarin tuaj.

NJIHUNI ME PERSONAZHET

NË KËTË TREGIM

Mohamedi

Jam 17 vjeç. Shumicën e kohës jam i lumtur. Më pëlqen të ndihmoj miqtë dhe familjarët e mi sa herë që mundem. Mbërrita vetëm para disa javësh dhe jam duke kërkuar gjyshin tim. Mezi pres të filloj të punoj.



Ahmedi

Jam 15 vjeç. Kam ardhur me motrën time të vogël, Jasminën, e cila është kujdesur për mua që kur vdiq nëna jonë. Më pëlqen të dal dhe të bëj miq të rinj. Dua të kthehem në shkollë sa më shpejt. Tani për tani, jam duke mësuar gjuhën vendase këtu.



Jasmina

Jam 24 vjeç. Kam ardhur së bashku me vëllanë tim, Ahmedin, për të cilin kujdesem aq sa mundem. Nuk kemi shumë kohë që kemi mbërritur, dhe po përpiqemi të bashkohemi me xhaxhanë tonë, i cili ka kohe që jeton në Evropë. Më pëlqejnë shumë sportet dhe luaj shumë mirë futboll.



Adami

Jam 9 vjeç. Kam ardhur vetëm këtu. Tani për tani, kam vendosur të mos flas. Kam përjetuar shumë gjëra të këqija përpara se të vija këtu. Më duhet pak kohë që të filloj të flas sërish. Por jam i zgjuar dhe arrij të kuptoj gjithçka. Jam shumë i vëmendshëm dhe dua të shkoj në shkollë. Më pëlqejnë të gjithë miqtë e rinj që kam bërë deri tani.



Znj. Ines

Unë punoj si kujdestare pranë kësaj qendre pritjeje. Përpiqem t'i ndihmoj sa më shumë të gjithë fëmijët dhe të rinjtë azilkërkues. Më pëlqen shumë të gatuj dhe gëzohem shumë kur të gjithë janë të zënë dhe aktivë. Aktiviteti fizik na ndihmon të ruajmë shëndetin fizik dhe mendor.



Z. Fred


Unë jam këshilltar ligjor, që është një lloj avokati. Punoj këtu së bashku me shumë kolegë të tjerë të mirëpërgatitur. Unë u jap informacion dhe mbështetje të gjithë azilkërkuesve lidhur me çështjet ligjore dhe kërkesat e tyre për azil. Më pëlqen të vesh bluza shumëngjyrëshe me shkrime.



Një falënderim i përzemërt shkon për të gjithë azilkërkuesit e rinj
që e lexuan këtë tregim përpara se të botohej dhe ndihmuan
që ai të përfundohej kaq bukur.

Ata kanë ndihmuar edhe në zgjedhjen e emrave të personazheve kryesore.

Falënderojmë gjithashtu autoritetet e Maltës dhe të Holandës që ndihmuan
në bashkëbisedimet me adoleshentët.



PËRSHËNETJE, Z. FRED. DUAM
TË DIMË MË SHUMË RRETH
PROCEDURËS SË AZILIT!



... DHE ÇFARË
NDODH GJATË
INTERVISTËS
PERSONALE PËR
AZIL...



... DHE PASI MERRET
NJË VENDIM...



UAI, SA PYETJE PASKENI! DO T'JU BËJ NJË
PËRMBLEDHJE TË PËRGJITHSHME.
PËR DETAJE SPECIFIKE PËR SITUATËN TUAJ,
KALONI SËRISH NJË DITË TJETËR DHE DO T'JU
TREGOJ MË SHUMË.





NËSE NUK MUND TË KTHEHENI NË VENDIN
TUAJ PËR SHKAK SE ATY DO TË ISHIT TË
PASIGURT, MUND TË KËRKONI AZIL.

EDHE PSE TË DREJTËN PËR TË KËRKUAR AZIL
E KANË TË GJITHË, JO TË GJITHË DO TË
PËRFITOJNË MBROJTJE.



ÇFARË NËNKUPTONI ME
MBROJTJE?


MBROJTJA DO TË THOTË SE JU
MUND TË QËNDRONI NË VENDIN
KU KENI KËRKUAR AZIL PËR AQ
KOHË SA KENI NEVOJË.



FAKTI NËSE DO TË PËRFITONI APO
JO MBROJTJE VARET NGA ARSYET
PSE MENDONI SE VENDI JUAJ I
ORIGINËS NUK ËSHTË I SIGURT
PËR JU. PËR SHEMBULL...

Nëse keni frikë të ktheheni
për shkak të:

- ngjyrës së lëkurës suaj
- fesë, kulturës apo traditave
që ju praktikoni
- grupit tuaj etnik
- bindjeve politike tuaja apo
të familjes suaj
- personit që dashuronit dhe
me të cilin dëshironi të jeni
- një grupi të cilit i përkisni,
i cili nuk pranohet



...GJITHASHTU, JU MUND TË PËRFITONI MBROJTJE EDHE NË RAST SE VENDI JU AJ ËSHTË NË LUFTË APO DO TË PËRBALLESHT ME TRAJTIM TË DHUNSHËM NËSE DO TË KTHEHESHIT ATY.

KËTO JANË DISA PREJ ARSYEVE PSE NJERËZIT LARGOHEN NGA VENDET E TYRE.



PRA, NËSE UNË NUK JAM I SIGURT DHE VENDI IM NUK MUNDET DHE NUK DO TË MË MBROJË, MUND TË KËRKOJ AZIL?



PIKËRISHT!



NË DISA VENDE, TË JESH VAJZË MUND TË JETË E RREZIKSHME, PASI VAJZAT NUK MUND TË LËVIZIN LIRISHT, MUND TA KENË TË NDALUAR TË SHKOJNË NË SHKOLLË APO MARTOHEH ME DETYRIM, NDËRSA...



...NË DISA VENDE TË TJERA, NJERËZIT MUND TË JENË NË RREZIK PËR SHKAK TË NJË PROBLEMI SHËNDETËSOR APO NJË AFTËSIE TË KUFIZUAR QË ATA KANË.







NËPUNËSIT DO T'JU BËJNË SHUMË PYETJE, PËR TË MËSUAR SA MË SHUMË RRETH JUSH. NDANI HISTORINË TUAJ.



GJITHASHTU, ÇDO PERSON NËN 18 VJEÇ QË KA MBËRRITUR VETËM DUHET T'U TREGOJË MENJËHERË NËPUNËSVE, PASI FËMIJËT KANË NEVOJË PËR MË SHUMË MBËSHTETJE SESA TË RRITURIT.



MË PAS, DO TË CAKTOHET NJË KUJDESTAR I PËRKOHSHËM PËR JU. BRENDA 3 JAVËVE PAS KËRKESËS PËR AZIL, DO TË CAKTOHET NJË KUJDESTAR I PËRHERSHËM PËR T'JU ARDHUR NË NDIHMË.


NËPUNËSIT QË BISEDOJNË ME JU JANË TË TRAJNUAR DHE DO TË BËJNË MAKSIMUMIN PËR T'JU ARDHUR NË NDIHMË.

ATA DO TË PËRPIQEN TË MARRIN NË KONSIDERATË DËSHIRAT, NEVOJAT DHE SHQETËSIMET TUAJA PËRPARA SE TË MARRIN VENDIME TË RËNDËSISHME. GJITHASHTU, ATA INFORMOHEN MIRË PËR VENDIN TUAJ, NË MËNYRË QË TA KUPTOJNË MË MIRË SITUATËN TUAJ.











JU MUND T'I BËNI PYETJE
KUJDESTARIT. NËSE JENI ME
FAMILJEN TUAJ DHE NUK JENI TË
SIGURT PËR GJËRA TË CAKTUARA,
KËRKONI NDIHMËN E NJË AVOKATI.

NDIHMJA E TIJ ËSHTË FALAS GJATË
TË GJITHË PROCEDURËS.



PAS REGJISTRIMIT, MË DHANË
NJË DOKUMENT QË TREGONTE
SE JAM KËRKUES.



PO, KY DOKUMENT
TREGON SE KENI BËRË
KËRKESË PËR AZIL. AI
ËSHTË SHUMË I
RËNDËSISHËM. RUAJENI
ME KUJDES.

I BËRA NJË FOTOGRAFI
DHE E RUAJTA NË
TELEFONIN TIM...



TË LUMTË!



Z. FRED, GJYSHI IM NDODHET KËTU, NË EVROPË. TANI QË KAM STATUSIN E KËRKUESIT, A MUND TË UDHËTOJ PËR T'U BASHKUAR ME TË?



ENDE JO. QËNDRO NË VENDIN KU JE REGJISTRUAR. AUTORITETET, NË BASHKËPUNIM ME JU DHE ME KUJDESTARIN TUAJ, DO TË VENDOSIN NËSE DHE SESI DO TË BASHKOHENI ME TË.



PËRPARA SE TË MERRNI VENDIMIN E RËNDËSISHËM PËR T'U LARGUAR NGA NJË VEND DREJT NJË VENDI TJETËR, BISEDONI ME KUJDESTARIN TUAJ APO ME NJË AVOKAT PËR TË KUPTUAR PASOJAT.



...GJITHASHTU, TË UDHËTUARIT VETËM MUND TË JETË ME RREZIK!



E KUPTOJ QË DUHET TË QËNDROJ KËTU.



NDËRKOHË QË PRESIN INTERVISTËN E TYRE PËR AZIL, KU FLENË DHE KU HANË NJERËZIT?



AUTORITETET DUHET T'JU SIGUROJNË NJË VEND TË SIGURT DHE TË PËRSHTATSHËM PËR TË QËNDRUAR. KJO QUHET PRITJE. ATO DO T'JU SHRJEGOJNË SESI MUND TË GJENI USHQIME DHE SENDET BAZË TË NEVOJSHME.

ZAKONISHT, FËMIJËT E SHOQËRUAR NGA FAMILJA QËNDROJNË NË AMBIENTE STREHIMI PËR FAMILJE.

QENDRA E STREHIMIT



FËMIJËT QË JANË VETËM MUND TË VENDOSEN ME FËMIJË TË TJERË NË SITUATË TË NGJASHME DHE NË VARËSI TË NEVOJAVE TË TYRE.

NËPUNËSIT DO T'JU INFORMOJNË SE KU MUND TË MËSONI GJUHËN VENDASE...




... TË FREKUENTONI SHKOLLËN, TË GJENI PUNË APO TË VIZITOHENI TE MJEKU, SIPAS NEVOJËS.



MBUSHENI KOHËN E LIRË ME AKTIVITETE NDËRKOHË QË PRISNI PËR INTERVISTËN TUAJ DHE KËRKONI NDIHMËN E NJË AVOKATI PËR T'U PËRGATITUR PËR TË.

NËSE NDIHENI TË SHQETËSUAR, TË STRESUAR OSE TË TREMBUR, FLISNI ME NJË PERSON TË BESUAR. NËPUNËSIT MUND T'JU VIJNË NË NDIHMË VETËM NËSE E DINË ÇFARË JU SHQETËSON.



JU DHE KUJDESTARI JUAJ DO TË MERRNI ME EMAIL
OSE ME POSTË NJË FTESË ME SHKRIM PËR
INTERVISTËN, ME DATËN, ORËN DHE VENDIN E SAJ.



FËMIJËT DUHET TË INTERVISTOHEN NË
PRANINË E NJË TË RRITURI QË ËSHTË
PËRGJEGJËS PËR TA, SI PRINDI APO
KUJDESTARI.



ÇFARË NDODH NËSE JAM
SËMURË ATË DITË?

JU OSE KUJDESTARI JUAJ DUHET
TË NJOFTONI AUTORITETET
MENJËHERË.



HËM... ÇFARË NDODH GJATË
INTERVISTËS PËR AZIL?



GJATË INTERVISTËS, NJË PERSON I
QUAJTUR "NËPUNËSI I NGARKUAR
ME TRAJTIMIN E RASTIT"...

DO T'JU BËJË PYETJE NË LIDHJE ME
FAMILJEN TUAJ, JETËN NË VENDIN TUAJ,
SITUATËN E SIGURISË ATY, ARSYEN PSE JENI
LARGUAR DHE UDHËTIMIN TUAJ. ÇDO GJË
QË THONI MBETET KONFIDENCIALE, PRA NUK
NDAHET ME ASKËND.





HËM... NUK ËSHTË E LEHTË TË MBAHEN MEND GJITHË KËTO GJËRA...



E DI, ËSHTË E VËSHTIRË. POR NËPUNËSIT JANË TË TRAJNUAR DHE DO T'JU NDIHMOJNË.



DIKUSH MË THA SE NGJAN SI NJË PROVIM.



PËRPIQINI TË PËRGATITENI ME KUJDESTARIN TUAJ APO ME NJË AVOKAT.

NË RREGULL. SA ZGJAT INTERVISTA?



MUND TË MARRË PAK KOHË, SIDOMOS NËSE ËSHTË I PRANISHËM NJË PËRKTHYES. NËSE JENI TË LODHUR, MUND TË KËRKONI TË BËNI NJË PUSHIM.



PO SIKUR TË MOS DI T'I PËRGJIGJEM NJË PYETJEJE?

BËNI MAKSIMUMIN. NËSE I KENI HARRUAR DETAJE TË CAKTUARA, THUAJENI KËTË. JEPNI SA MË SHUMË INFORMACIONE QË TË MUNDENI. NË VEND QË TË JEPNI DATAT EKZAKTE, MUND TË THONI SE ISHTE VERË APO PERIUDHA AFËR NJË FESTE TË CAKTUAR.

MJAFTON TË MOS SHPIKNI GJËRA.



NË FUND, NËPUNËSI DO T'I KONFIRMOJË PËRGJIGJET TUAJA SË BASHKU ME JU. NËSE KANË SHËNUAR DIÇKA GABIM, KËRKOJUNI TA KORRIGJOJNË. ËSHTË E VËSHITRË TË BËHEN NDRYSHIME MË VONË.

A MUND TË SJELL LETRA, RAPORTE NGA SHKOLLA APO RAPORTE MJEKËSORE DHE ARTIKUJ GAZETASH PËR TË VËRTETUAR HISTORINË TIME?

SIGURISHT!



...PO DEKLARATA NGA MIQ OSE FAMILJARË APO FOTOGRAFI TË DOKUMENTEVE TË TILLA SI CERTIFIKATA E LINDJES?



PO, PËR SA KOHË QË ATO SHËRBEJNË PËR TË SHRJEGUAR HISTORINË TUAJ DHE ARSYEN PSE JU ËSHTË DASHUR TË LARGOHENI.

MIQTË DHE FAMILJARËT MUND TË MË NDIHMOJNË TA GJEJ KËTË INFORMACION.



PO, POR ATA NUK DUHET TA VËNË VETEN NË RREZIK. NJOFTONI NËPUNËSIT NËSE JU DUHET MË TEPËR KOHË.



NËSE INFORMACIONI NDIHMON PËR MARRJEN E NJË VENDIMI, INTERVISTA JUAJ MUND TË SHTYHET.



NJË MIK MË THA SE AUTORITETET NUK PRANOJNË TA SHQYRTOJNË KËRKESËN E TIJ PËR AZIL. PËRSE KËSHTU?



AUTORITETET FILLISHT VERIFIKOJNË NËSE ËSHTË E NEVOJSHME TA SHQYRTOJNË NJË KËRKESË PËR AZIL OSE JO.



PËRJETIMET TUAJA MUND TË PËRMBAJNË INFORMACION TË RËNDËSISHËM. NËPUNËSIT DO TË PËRPIQEN T'JU NGUSHËLLOJNË. ATA MUND TË BËJNË NJË PUSHIM APO TË KËRKOJNË PËRFSHIRJEN E DIKUJT QË MUND T'JU NDIHMOJË, NËSE SHOHIN SE JENI NË VËSHTIRËSI.



TË GJITHË PERSONAT QË PUNOJNË KËTU DUHET T'JU TRAJTOJNË ME RESPEKT. NË TË KUNDËRT, MUND TË BËNI NJË ANKESË ZYRTARE. KËRKONI NDIHMËN E NJË PERSONI TË BESUAR.




NJË MIKUT TIM IA NDËRPRENË INTERVISTËN DHE I KËRKUAN TË VIZITOHEJ TE NJË MJEK. PSE?



HËM... NUK I DI DETAJET...

NDONJËHERË, DIKUJT MUND T'I KËRKOHEJ TË KRYEJË NJË ANALIZË MJEKËSORE, NËSE NËPUNËSI MENDON SE REZULTATET E SAJ MUND TË NDIHMOJNË KËRKESËN PËR AZIL.



NDOSHTA PERSONI KA NJË
PROBLEM SHËNDETËSOR APO
MENDOR QË NUK ËSHTË
KONSTATUAR MË PARË DHE
KËRKON TRAJTIM. HAPAT E
TJERË DO TË VENDOSEN NË
BAZË TË REZULTATEVE.




NËPUNËSIT DO T'JU
PYESIN NËSE JENI
DAKORD T'I KRYENI
ANALIZAT. KUR JENI TË
MITUR, DO TË
PËRFSHIHEN EDHE
PRINDËRIT OSE
KUJDESTARI JUAJ.



HËM... SI MUND TA KUPTOJ NËSE
E KAM FITUAR APO JO TË
DREJTËN PËR AZIL?



PAS INTERVISTËS, NËPUNËSIT
DO TË SHQYRTOJNË TË GJITHË
INFORMACIONIN DHE DO TË
MARRIN NJË VENDIM NË LIDHJE
ME KËRKESËN TUAJ. MUND TË
KALOJË PAK KOHË PËRPARA SE
TË MERRNI NJË LETËR QË
SHRJEGON VENDIMIN.



E KUPTOVA. PRANDAJ MË KËRKUAN NUMRIN
E TELEFONIT DHE ADRESËN AKTUALE, QË TË
MUND TË MË KONTAKTOJNË.



PO! NËSE VENDIMI ËSHTË POZITIV, PERSONI MUND TË QËNDROJË DHE TË PËRFITOJË NJË FORMË MBROJTJEJE.



SI PËR
SHEMBULL
STATUSIN E
REFUGJATIT,
APO JO?



PO! ...OSE
MBROJTJEN
PLOTËSUESE.



NË TË DY RASTET, JU
MERRNI LEJE QËNDRIMI
PËR TË QËNDRUAR KËTU
PËR AQ KOHË SA JU
NEVOJITET MBROJTJE.
NJË AVOKAT MUND T'JU
SHRJEJOJË DETAJET.

NË RASTIN E NJË VENDIMI NEGATIV, JU NUK MUND
TË QËNDRONI, PASI ËSHTË VLERËSUAR SE MUND
TË KTHEHENI TË SIGURT NË VENDIN TUAJ TË
ORIGINËS OSE NË VENDIN KU JETONIT MË PARË.



NËSE NUK JENI DAKORD, MUND TA APELONI
VENDIMIN, PRA TË KËRKONI RISHQYRTIM TË
RASTIT TUAJ.




A ËSHTË I NDËRLIKUAR
APELIMI?



PAK.



DO T'JU DUHET TË PLOTËSONI MENJËHERË FORMULARËT.
KËRKONI NDIHMË DHE MOS HARRONI SE APELIMI ËSHTË
THJESHT NJË SHQYRTIM, DHE JO GARANCI PËR MBROJTJE.



DUKENI TË GJITHË
SHUMË TË LODHUR. LE
TA MBYLLIM PËR SOT.

EDHE NJË PYETJE... KAM
DËGJUAR NËPUNËSIT TË
FLASIN PËR PROCEDURËN
NË KUFİ DHE PROCEDURËN
E KTHIMIT...



PROCEDURA E KTHIMIT
ËSHTË PËR ATA QË
DUHET TË KTHEHEN,
PASI VENDI I TYRE
KONSIDEROHET I
SIGURT.



DISA NJERËZ MUND TË VENDOSIN TË KTHEHEN
VULLNETARISHT. NJOFTONI NËPUNËSIT PËR TË
PËRFITUAR MBËSHTETJE.



PROCEDURA NË KUFİ NËNKUPTON SE KËRKESA JUAJ
PËR AZIL SHQYRTOHET NË PIKËN KUFITARE AJRORE,
TOKËSORE APO DETARE KU KENI MBËRRITUR.



JU MUND T'JU DUHET TË QËNDRONI
ATY DERISA TË MERRET NJË VENDIM
PËR RASTIN TUAJ DHE NUK MUND TË
LËVIZNI LIRISHT.



FËMIJËT QË MBËRRIJNË
ME FAMILJEN MUND T'I
NËNSHTROHEN PROCEDURËS
NË KUFİ, QË ZGJAT 3 DERI
NË 4 MUAJ.



FËMIJËT QË MBËRRIJNË TË
VETËM NUK I NËNSHTROHEN
PROCEDURËS NË KUFİ.
MEGJITHATË, KA DISA
PËRJASHTATË.

BISEDONI ME KUJDESTARIN TUAJ PËR
TË MËSUAR MË SHUMË.



E RËNDËSISHME

Në këtë vend ...

Autoriteti përgjegjës për të më regjistruar dhe për të organizuar intervistën time personale për azil quhet: _____

Emri i kujdestarit(es) tim(e) është: _____

Unë mund të kontaktoj një avokat pa pagesë për të mësuar më shumë rreth procedurës së azilit dhe për t'u përgatitur për intervistën time.

Për këtë, mund të kontaktoj: _____

Nëse nuk jam dakord me vendimin lidhur me kërkesën time për azil, mund të kontaktoj kujdestarin tim dhe një avokat për këshillim lidhur me mënyrën e apelimit.

Informacioni i mëposhtëm mund të jetë i dobishëm për apelimin: _____

Nëse ndonjë nga personat që punojnë këtu, si nëpunësit, këshilltarët ligjorë, punonjësit socialë ose kujdestari im më trajtojnë keq, mund të bëj një ankesë dhe të kontaktoj: _____

Në rast të një emergjence, mund të kontaktoj ambulancën në numrin _____ ose policinë në numrin _____



Nëse dëshiroj të kthehem vullnetarisht në vendin tim të origjinës, kujdestari im do të më ndihmojë të kontaktoj Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM): _____



Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) mund të ofrojë gjithashtu mbështetje për mua ose familjen time kur kemi pyetje lidhur me çështjet ligjore. UNHCR mund të kontaktohet në: _____

Informacione të tjera të rëndësishme: _____

KUIZ

Po testoj njohuritë e mia në lidhje me procedurën e azilit.

✓ Zgjidhni përgjigjen e saktë.

- 1 Njerëzit kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare ose azil për shkak se kanë frikë të kthehen në vendin e tyre, pasi ata ose familja e tyre do të ishin të pasigurt aty. a. E vërtetë
b. E gabuar
- 2 Autoritetet duhet të më regjistrojnë brenda 5 deri në 8 ditëve pas kërkesës sime për azil. Në rrethana përjashtimore, kjo mund të zgjasë deri në 2 javë. a. E vërtetë
b. E gabuar
- 3 Mund të udhëtoj ku të dua unë pasi të kem bërë kërkesën për azil. a. E vërtetë
b. E gabuar
- 4 Është e rëndësishme të bashkëpunoj me nëpunësit që më bëjnë pyetje gjatë intervistës sime personale për azil. Nëse nuk më kujtohet diçka, mund t'ua them këtë. a. E vërtetë
b. E gabuar
- 5 Fëmijët që mbërrijnë vetëm nuk i nënshtrohen procedurës në kufi. a. E vërtetë
b. E gabuar
- 6 Nëse kam pyetje në lidhje me intervistën personale për azil, mund të pyes kujdestarin tim ose një avokat. Ndihma e tyre është pa pagesë. a. E vërtetë
b. E gabuar
- 7 Nëpunësit do të konfirmojnë me mua informacionin që ata mbledhin gjatë intervistës personale për azil, në mënyrë që unë të mund të korrigjoj gabimet. a. E vërtetë
b. E gabuar
- 8 Nuk ka problem nëse nuk shkoj dot në takimin për intervistën time personale për azil. a. E vërtetë
b. E gabuar

KUIZ

9. Është mirë të ndaj me nëpunësit të gjitha dokumentet që kam, qoftë edhe fotografitë e këtyre dokumenteve që kam në telefon.
- a. E vërtetë
b. E gabuar
-
10. Pas intervistës personale për azil, nëpunësit do ta shqyrtojnë të gjithë informacionin dhe do të vendosin nëse kam apo jo nevojë për mbrojtje.
- a. E vërtetë
b. E gabuar
-
11. Nëse nuk jam dakord me vendimin e tyre, mund të bisedoj me kujdestarin tim apo me një avokat dhe ta apeloj vendimin.
- a. E vërtetë
b. E gabuar

Përgjigjet për kuizin

Pyetja 1: a; Pyetja 2: a; Pyetja 3: b; Pyetja 4: a; Pyetja 5: a; Pyetja 6: a; Pyetja 7: a; Pyetja 8: b; Pyetja 9: a; Pyetja 10: a; Pyetja 11: a.

SHËNIME

ALBANIAN

Kjo broshurë është vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë broshurë nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. As EUAA dhe as personat që veprojnë në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban ky botim.

© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin, 2025

